



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers*

THIRRJE PUBLIKE PËR ORGANIZATAT JO-QEVERITARE DHE ENTITETET
TJERA QË OFROJNË SHËRBIME SOCIALE PËR KATEGORITË E CENUESHME TË
SHOQËRISË PËRMES PAKOVE USHQIMORE

Konteksti

Në kuadër të realizimit të masave konkrete të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka planifikuar të ofrojë mbështetje financiare për organizatat jo-qeveritare/entitetet të cilat ofrojnë shërbime sociale për kategoritë e cenueshme të shoqërisë, përmes pakove ushqimore. Rrjedhimisht, nëpërmjet kësaj shpalljeje ftohen të gjitha organizatat jo-qeveritare dhe entitetet tjera që të aplikojnë për këtë mbështetje financiare.

Qëllimi

Mbështetja financiare synon ta realizojë qëllimin e shpërndarjes së pakove ushqimore për kategoritë e cenueshme të shoqërisë, si dhe të sigurojë që pjesa e konsiderueshme e mjeteve financiare nga ky financim të shpenzohen për blerjen e produkteve vendore.

Vlera e mbështetjes financiare

Vlera e mbështetjes financiare për çdo organizatë apo entitet, që aprohet nga Komisioni, varet nga kapaciteti dhe intensiteti shërbyes i organizatës apo entitetit dhe mund të jetë deri është 50.00 € për pako. Këto mjete shfrytëzohen për mbulimin e produkteve të pakove ushqimore që shpërndahen për kategoritë e cenueshme të shoqërisë.

Së paku 70 % (shtatëdhjetë për qind) e vlerës së produkteve që përmban një pako ushqimore duhet të jenë produkte vendore.

Kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen

1. Të jetë organizatë jo-qeveritare apo entitet tjetër (institucion me status të veçantë, bashkësi fetare, institucion publik apo të ngjashme) i regjistruar në Republikën e Kosovës sipas legjislacionit përkatës në fuqi para datës 1 janar 2022;
2. Të ketë zhvilluar aktivitete të ofrimit të shërbimeve sociale për kategoritë e cenueshme të shoqërisë përmes, ndër tjerash, pakove ushqimore; dhe
3. Të zhvillojë të gjitha aktivitetet e organizatës apo entitetit sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Dokumentet e nevojshme dhe mënyra e aplikimit

Aplikacionet duhet të dërgohen përmes e-mail adresës **masa3.4@rks-gov.net** deri më datë **7 prill 2022** dhe duhet të përmbajnë dokumentacionin në vijim:

1. Certifikatën apo dokumentin e regjistrimit të organizatës apo entitetit;

2. Dëshminë se veprimtaria e organizatës apo entitetit është ofrimi i shërbimeve sociale për kategoritë e cënueshme të shoqërisë përmes, ndër tjerash, pakove ushqimore;
3. Planin për realizimin e aktiviteteve nga mbështetja financiare (planin e punës, planin biznesor apo të ngjashme).

Procesi i përzgjedhjes

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve do të themelojë një Komision të pavarur për shqyrtimin e aplikacioneve. Pas shqyrtimit të aplikacioneve, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve do të lidhë marrëveshje për përcaktimin e përgjegjësive të palëve me organizatat apo entitetet e aprovuara nga Komisioni.

Palët e interesuara mund të kërkojnë sqarime shtesë për këtë thirrje publike nëpërmjet e-mail adresës masa3.4@rks-gov.net